

V E N D I M

Nr. 825, datë 30.12.1998

PËR DISA MASA PËR RIAKTIVIZIMIN DHE LIKUIDIMIN E DISA NDËRMARRJEVE TË PËRBASHKËTA, NË SISTEMIN E BUJQËSISË DHE USHQIMIT

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr. 8283, datë 3.2.1998 “Për buxhetin e shtetit për vitin 1998”, me propozimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

1. Për riaktivizimin e ndërmarrjes së përbashkët “Agri-Gose” sh.p.k. Kavajë:

a) T’i jepen kësaj shoqërie në përdorim 78.98 ha tokë bujqësore, disponibël, shtetërore në zonën e Bashtovës, në veri të lumit Shkumbin, me numër kadastral a.35=45,45 ha; a.36=3,11 ha; a.38=30,42 ha; në këmbim të sipërfaqes prej 50 ha tokë bujqësore në Gose, në vijim të kushteve kontraktore përkatëse.

b) Shoqëria “Agri-Gose”, sh.p.k., Kavajë, të paguajë, në favor të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, kontributin e papaguar për periudhën 1993-1998, pa kamatëvonesat përkatëse. Kamatëvonesat prej 12 milionë lekësh, të përballohen nga buxheti i shtetit.

2. Për riaktivizimin e ndërmarrjes së përbashkët “Pranvera” sh.p.k., Sukth, Durrës:

a. T’i jepet kësaj shoqërie në përdorim edhe 6 ha tokë bujqësore të tjera në zonën e ish NB-së, Spitalllë, pjesë e parcelës me numër kadastral 76.

b. Pjesës së kapitalit të ortakut shtetëror shqiptar, t’i shtohet, si kontribut në natyrë, një magazinë e degës së farnave, Shijak.

c. Ministria e Pushtetit Lokal të marrë masa për sistemimin me zyra të bashkisë së Sukthit.

3. Për riaktivizimin e ndërmarrjes së përbashkët “Al-Gr-Vurg” sh.p.k., Sarandë, pjesës së kapitalit të ortakut shtetëror, shqiptar t’i shtohen, si kontribut në natyrë, tri objekte nga Ndërmarrja e Ujërave, Tiranë.

4. Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit i shtohen 20 milionë lekë nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave. Ky fond të përdoret për të paguar pagat, kontributin e sigurimeve shoqërore dhe shpenzime të tjera për punonjësit e domosdoshëm në ndërmarrjet e përbashkëta, të cilat kanë ndërprerë veprimtarinë që para disa viteve dhe po negociohet ose janë futur në procesin e likuidimit dhe të privatizimit. Efektet financiare i shtrin që nga data 1.7.1997.

Të ardhurat nga likuidimi dhe privatizimi i këtyre ndërmarrjeve, t’i kalojnë Buxhetit të Shtetit.

5. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit, Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Ministria e Financave, Ministria e Pushtetit Lokal dhe këshillat e rretheve Durrës, Kavajë e Lushnjë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI
Pandeli Majko**

